PËRSE NUK AGJËRUAN?

-studim në teren i shkaqeve dhe arsyeve të atyre që nuk praktikojnë agjërimin në qytetin e Vushtrrisë-

Hulumtues: Sedat ISLAMI, Ph.D. Candidate

Abstrakt

Agjërimin, ndryshe nga obligimet tjera fetare, besimtarët vushtrrias e kanë përfillur më shumë. Me kalimin e kohës, jo vetëm që është zbehur paksa praktikimi i agjërimit, porse është shfaqur edhe dukuria e ngrënies dhe pirjes në publik, gjë që më parë nuk ka qenë me këto përmasa. Kështu, ky studim mëton të zbulojë shkaqet që qëndrojnë prapa këtyre veprimeve. Studimin e kam ndarë në dy pjesë, në të parën prej të cilave kam folur për agjërimin, normën, vlerën dhe rëndësinë e tij, ndërsa në të dytën kam diskutuar për shkaqet që kanë sjellë këtë gjendje. Studimin e kam mbyllur me një pasthënie, në të cilën kam nënvizuar disa prej rezultateve kryesore si dhe disa propozime konkrete për temën e studiuar.

Fjalët kyçe: agjërimi, ramazani, feja, mosagjërimi, tradita vushtrriase.

HYRJE

Agjërimi është një nga adhurimet që zënë vend të rëndësishëm në Islam. Profeti Muhammed [*alejhis salatu ves selam*] e radhit si njërën ndër pesë shtyllat kryesore të fesë. Në hadithin e Ibni Omerit [*radijAllahu anhuma*] qëndron se Pejgamberi [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] ka thënë: *"Islami është ngritur mbi pesë shtylla: që të njëjësohet Allahu, të falet namazi, të jepet zekati, të agjërohet ramazani dhe (të kryhet) haxhi."*[1]

Agjërimi, si adhurim, qe praktikuar edhe më parë, ndërsa agjërimi i Ramazanit, si shtyllë e fesë dhe obligim i veçantë, nuk ka ndodhur vetëm se në vitin e dytë sipas hixhrit. Që nga ajo kohë, muslimanët kanë vazhduar t'i kushtojnë rëndësi të madhe agjërimit të këtij muaji. Jo vetëm gatishmëria për të çuar në vend një urdhër të Allahut, por edhe motivimi nga mirësitë dhe karakteristikat e tij si dhe atmosfera e veçantë që përjetohet në këtë muaj, kanë bërë që ata të harrojnë lodhjen e urisë dhe etjes dhe të jetojnë me kënaqësitë e tij.

Kështu, me këtë frymë adhurimi e dashamirësie, e kanë pritur edhe besimtarët e trojeve tona. Bile, aq e kanë vlerësuar saqë atë që nuk agjëron e kanë llogaritur si shka.[2] Agjërimi është kultivuar edhe si traditë dhe kulturë. Atmosfera e tij ka qenë si një lloj festivali lokal. Kjo është vërejtur më shumë në qytete të vogla, të cilat kanë ruajtur traditat dhe vlerat më shumë. Gjithsesi, qyteti i Vushtrrisë i njohur për këtë atmosferë. Edhe ata që nuk kanë agjëruar, e që nuk kanë qenë të shumtë, e kanë pritur me gëzim. Kafenetë ku shërbehej alkool, për nder të këtij muaji, shërbenin vetëm çaj dhe pije tjera të lejuara fetarisht. Ata që nuk agjëronin, nuk hanin/pinin në publik. Zakonisht, kafenetë që shërbenin gjatë ditës, vënin perde të errëta që të mos dukeshin ata që ishin brenda. Kishte një çikë turpi dhe respekti për Ramazanin.

Kështu ka vazhduar për vite. Gjendja ka filluar të ndryshojë vetëm këtyre viteve të fundit, ku ky respekt është zbehur deri në një masë. Një pjesë e atyre që nuk agjërojnë tanimë nuk kursehen nga ngrënia dhe pirja në publik, diç kjo e pazakontë për traditën tonë. Kështu, ky studim, i pari i llojit të vet, ka ardhur për të hulumtuar për shkaqet që kanë shkaktuar këtë ndryshim tradite.

Phoca PDF

Respektivisht, ka ardhur për t'i gjetur përgjigjen pyetjeve në vijim:

1. A është mungesa e njohurive fetare shkak për mos praktikimin e agjërimit nga ana e tyre?
2. A kanë ndikuar familja, rrethi dhe kultura globale në braktisjen e këtij obligimi fetar dhe shmangien prej kësaj tradite dhe kulture të respektimit të këtij muaji të madhërishëm?
3. A ka ndikuar kultura perëndimore në braktisjen e agjërimit?
4. A janë fetarisht të justifikuara arsyetimet që japin për braktisjen e agjërimit?
5. Ngrënia dhe pirja në publik, si veprim i gjykuar fetarisht, është shkak i një neglizhence shpirtërore apo thjesht i një shpërfillje të qëllimshme?

Studimit i kam vënë si qëllim kryesor që të zbuloj shkakun e vërtetë që qëndron prapa braktisjes së agjërimit dhe ngrënies dhe pijes në publik, në mënyrë që gjykimet tona për këto veprime të jenë të studiuara mirë, të jenë mbi bazën e asaj që ata besojnë dhe veprojnë dhe jo mbi bazën e asaj se si ne i shohim të veprojnë. Kështu, Islamin do të mund tua paraqisnim si zgjidhje, si diç që iu mungon, që iu duhet. Kjo edhe është objektiva kryesore, që të evidentojmë shkaqet e pastaj t'i drejtohemi atyre në mënyrën e duhur. Për këtë qëllim, kemi bërë një pyetësor, të cilin e kemi shpërndarë në qytet ndërsa target grupe kemi patur të gjithë ata që nuk agjërojnë, pavarësisht moshës dhe gjinisë së tyre. Më qartë, respondentët i kemi ndarë sipas gjeneratave:

1. mosha e re 15-25 (30 respondentë),
2. mosha e mesme 25-55 (40 respondentë),
3. mosha vjetër 55 e tutje (30 respondentë).

Me këtë kemi synuar të dallojmë shkaqet tek të rinjtë dhe të vjetrit, tek femrat dhe meshkujt, për të vlerësuar më pas se sa janë të përbashkëta dhe sa dallojnë, sa janë të justifikueshme për moshën/gjininë dhe sa jo.

Studimin e kam ndarë në dy pjesë kryesore, të paraprira me një parathënie dhe pasuara nga një pasthënie.

Në *Parathënie* kam shpjeguar problematikën e studimit dhe qëllimet e tij.

Në pjesën e parë, të cilën e kam titulluar *"Rreth agjërimit në Islam"*, kam folur për agjërimin nga perspektiva islame, respektivisht jam munduar të ofroj një tablo dhe portret se si duket agjërimi dhe si ndikon ai në kultivimin e vlerave shpirtërore dhe morale. Kam folur për historikun dhe normën e agjërimit, sikur që jam marrë me urtësitë dhe mësimet që përfitojmë prej tij, në njërën anë, dhe reflektimin e tyre në sjelljet dhe veprimet tona, në anën tjetër. Thjesht, jam munduar që, për pyetjet e parashtruara në pyetësor, paraprakisht të ofroj një koncept të përgjithshëm, në mënyrë që lexuesi trajtimin e shkaqeve në pjesën vijuese ta kuptojë më lehtë.

Ndërsa në pjesën e dytë, të cilës i kam vënë titullin *"Analizimi i shkaqeve dhe arsyetimeve të atyre që nuk agjërojnë dhe që hanë e pinë në publik gjatë ditës në Ramazan"*, jam marrë ekskluzivisht me elaborimin e përgjigjeve të tyre, të cilat i kam sjellë në kuadër të shtjellimeve në formë të nëntitujve, ku kam sjellë një gjykim fetar për botëkuptimin (shkakun) e caktuar. Përgjigjet i kam shoqëruar edhe me tabela, në të cilat kam përshkruar përqindjet e ndikimit të target grupeve nga shkaku ose botëkuptimi i caktuar.

Phoca PDF

Ndërsa *Përfundimin* e kam rezervuar për disa nga rezultatet kryesore të studimit të shoqëruara dhe me disa propozime konkrete.

I. RRETH AGJËRIMIT NË ISLAM

1. HISTORIKU I AGJËRIMIT

Referuar Kur'anit, agjërimi është një adhurim i praktikuar edhe më parë. Edhe popujt që kanë qenë para nesh, respektivisht ithtarët e feve para shpalljes së Islamit, kanë agjëruar, ndonëse me dallime në disa çështje. Thotë Allahu: **"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."** (El-Bekare, 183)

Ky lloj agjërimi vazhdoi edhe në fillim të paraqitjes së Islamit. Aisheja, [*radijAllahu anha*], transmeton: *"Ashura ishte një ditë që e agjëronin kurejshitët edhe para ardhjes së Islamit. Edhe Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] e agjëronte, por kur erdhi në Medinë, përveç që e agjëroi vet, i urdhëroi edhe të tjerët ta agjërojnë. Kur erdhi obligimi për Ramazan, atëherë çështja mbeti vullnetare: Kush dëshironte e agjëronte e kush donte e linte."*[3]

Pra ishte ky agjërim që praktikonin ithtarët e Musait [*alejhiselam*] ai që u praktikua në fillim, për tu zëvendësuar më pas, si obligim, me agjërimin e Ramazanit. Kjo, siç përmendin shkollarët myslimanë, ka ndodhur në vitin e dytë të migrimit (hixhretit) në Medinë.

2. NORMA E AGJËRIMIT

Për normën e agjërimit flasin Kur'ani, Sunneti dhe konsensusi i muslimanëve. Thotë Allahu: **"O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."** (El-Bekare, 183) Ka thënë Ibni Xheriri: *"agjërimi u është bërë obligim"*, d.t.th.: iu është obliguar – bërë farz agjërimi i Ramazanit.[4]

Fakt tjetër që flet për agjërimin është dhe ajeti:"**…E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë…**" (El-Bekare, 183) Ka thënë Ibni Kethiri: "Ky është obligim i prerë për ata që përjetojnë këtë muaj. D.t.th.: për ata që janë vendas kur të hyjë Ramazani dhe janë të shëndoshë në trup."[5]

Ndërsa nga Sunneti ka fakte të shumta, ndër të cilat do të veçoja hadithin që transmeton Ibni Omeri [*radijAllahu anhuma*] nga Pejgamberi [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*]: *"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk meriton të adhurohet me të drejtë askush përveç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e Haxhit."*[6]

Ndërsa sa i përket konsensusit të dijetarëve muslimanëve, Ibni Hazmi thotë: *"Dijetarët janë pajtuar se agjërimi i Ramazanit është obligim – farz për atë që është i shëndoshë, vendas, i mençur, në moshën madhore, që e di se është muaji i Ramazanit dhe që është njoftuar se Ramazani duhet të agjërohet."*[7]

Agjërimi obligohet kur të përmbushen këto kushte:

Phoca PDF

1. Që të jetë mysliman, ngase jomyslimani nuk obligohet me agjërim.
2. Të jetë moshërritur, fëmija nuk obligohet me agjërim.
3. Të jetë i vetëdijshëm, ngase atij që i ka ikur mendja nuk i obligohet agjërimi.
4. Të ketë mundësi të agjërojë, sepse për të sëmurin ka rregulla të caktuara: i sëmuri i përkohshëm, i kompenson më vonë, ndërsa i sëmuri i përhershëm bënë shpagimin përkatës.
5. Të jetë vendas, udhëtari nuk obligohet të agjërojë gjatë kohës së udhëtimit.
6. Të mos ketë pengesa (menstruacionet, lehonia, etj).

3. VLERA E AGJËRIMIT TË RAMAZANIT DHE SHPËRBLIMI PËR TË

Agjërimi është një ndër veprat që kanë shpërblim të madh. Është ndër veprat e vetme shpërblimi për të cilat është i pakufizuar. Është Allahu Ai që shpërblen sa të do. Në këtë shpërblim është aluduar në Kur'an dhe në Sunnet. Ramazani është një muaj, begatitë e të cilit startojnë që nga dita e parë e tij. Pejgamberi [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] duke folur për agjërimin dhe vlerën e tij thotë: *"Kush agjëron Ramazanin me besim dhe llogari (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e mëparshme!"*[8]*; "Kush falet në Ramazan me besim dhe llogari (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e mëparshme!"* [9]*; "Kush falet Natën e Kadrit me besim dhe llogari (në shpërblimin e Allahut), i falen mëkatet e mëparshme!"* [10]*; "…agjëruesi ka dy gëzime me të cilat gëzohet: kur të bëjë iftar, gëzohet, si dhe gëzohet me agjërimin e tij kur ta takon Allahun e Madhëruar."* [11]*; "Vërtetë, në Xhennet është një derë, e cila quhet Rejjan, e nëpër të cilën hyjnë vetëm agjëruesit dhe askush tjetër!"* [12]

4. RËNDËSIA DHE EFEKTET E AGJËRIMIT TEK BESIMTARI

4.1. Në përmirësimin e raporteve me Allahun e Madhëruar

Agjërimi zhvillon në shpirt realitetin e sinqeritetit vetëm për Allahun. Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi, [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] ka thënë: *"Çdo vepër e njeriut ehte për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë shpërblej për të…"*[13] *Ka thënë Ibni Bettali: "Agjërimi dhe të gjitha veprat janë për Allahun, mirëpo, për shkak se në veprat e dukshme mund të jetë prezentë edhe syefaqësia prej djallit dhe të tjerëve, ndërsa në agjërim kjo është e pamundur, atëherë edhe shpërblimi ehte caktuar sipas sinqeriteti. Për këtë edhe lejohet t'i atribuohet Allahut agjërimi."*

4.2. Agjërimi dhe falënderimi për mirësitë

Shejhu Abdu'l Aziz es-Selman ka thënë: "Agjërimi fton për falënderim për Allahun. Kjo ngase njeriu gjatë agjërimit largohet nga ushqimi, pija dhe dëfrimi seksual, dhe ai vetëm tash kur t'i humbë këtu ua di vlerën. Kështu, (meqë ai në mbrëmje prapë i realizon ato), kjo gjë e motivon për ta falënderuar Allahun për to. Në këtë aludon edhe fjala e Allahut: "**…dhe që të falënderoni.** " El-Bekare, 185."

4.3. Agjërimi në shpirt dërgon sinjalet e frikës dhe kujdesit prej Allahut

Ka thënë Shejhu Muhammed Reshid Rida: "*Agjërimi i është ngarkuar shpirtit të agjëruesit, dhe përveç Allahut nuk ka asnjë mbikëqyrës. Kjo mbikëqyrje njeriut i dhuron turp që Allahu të mos e*

Phoca PDF

sheh atje ku e ka ndaluar. Kjo vërteton se sa i përsosur është imani dhe se sa shume madhërohet e respektohet Allahut, gjëra këto që sjellin edhe frikën prej Tij. Besimtari i pajisur me këtë tipar nuk lëshohet në mëkate ngase koha e pakujdesisë ndaj Allahut tek ai nuk zgjat. Ai po harroi shumë shpejt përkujton dhe kthehet e pendohet tek Allahu: **"Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)."** (El-A'rafë, 201)."

4.4. Në aspektin moral dhe edukativ

Agjërimi ruan gjymtyrët nga rënia në mëkate. Ebu Hurejre, siç shënon Buhariu, transmeton se Pejgamberi, [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] ka thënë: "*Ai që agjëron por nuk iu është larguar shpifjes dhe veprimit sipas saj, ai është sikur të mos ketë agjëruar fare ngase Allahu nuk ka nevojë për braktisje të ushqimit dhe pijes prej nesh*."

Agjërimi është një shtysë tjetër shpirtërore, duke e bërë besimtarin kësaj radhe, që karshi tjetrit, që mbase mund të jetë injorant, provokativ, konfliktuoz, të tregojë maturi dhe pjekuri në veprime. Nuk është trimëri të reagosh ndaj çdo sjelljeje të keqe, sidomos nëse ke të bësh me njerëz të ligë. Në këtë rast, trimëri është të lëshosh pe. Dhe ky është morali, të cilin Pejgamberi [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] na e mëson nëpërmjet agjërimit: "*Agjërimi është mburojë, andaj (agjëruesi) le të mos flet fjalë të pahijshme dhe le të mos shfaqë injorancë. E, nëse ndokush e provokon apo shan, le të thotë -dy herë-: unë jam agjërueshëm!…*"[14]

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë nga Ibni Mes'udi se: "*Ishim me Pejgamberin* [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] *ndërsa ai tha: Kush prej jush ka mundësi materiale, atëherë le të martohet ngase martesa të bën ta ruash shikimin dhe nderin. E kush nuk ka mundësi, atëherë le të agjërojë ngase agjërimi është mburojë.*"

4.5. Në aspektin shoqëror e social

Agjërimi e bën besimtarin më solidar, më human, më njerëzor, më pranë të varfrit. Mu për këtë, edhe shpërblimi për këtë vepër është goxha i madh. Hadithi i dyfishimit të shpërblimit të agjëruesit që ushqen besimtarët agjërues është dëshmi konkrete për këtë gjë. Pejgamberi [*sal-laAllahu alejhi ve sel-lem*] ka thënë: *"Kush i jep ushqim një të agjëruesi, ai ka shpërblimin edhe sikur të tij, duke mos iu cunguar aspak agjërimi këtij të fundit.*"[15]

Njëri nga të parët – selefi u pyet: Përse është ligjësuar agjërimi? Tha: "*Që i pasuri ta shijojë shijen e urisë e të mos e harrojë të uriturin.*" Muhammed Reshid Rida thotë: "*Kur agjëruesi të ndiejë uri, atëherë ai përkujton ata që gjithnjë janë të uritur kështu që kjo ia ngjall ndjenjat e butësisë dhe mëshirës, pasojë e të cilave janë dhënia dhe lëmosha. Allahu e përshkroi të dërguarin e Tij si i butë dhe mëshirshëm (reuf rehim), dhe për robërit e Tij pëlqen atë që pëlqeu për Muhammedin, [sal-laAllahu alejhi ve sel-lem] ndaj edhe i urdhëroi ta pasojnë atë.*" Ibni Abbasi rrëfen: "*Pejgamberi [sal-laAllahu alejhi ve sel-lem] ishte më bujari ndër njerëz kurse më bujari ishte në Ramazan kur e takonte Xhibrilin.*"[16]

4.6. Në aspektin shëndetësor dhe psikik

Shkencëtarët kanë vërtetuar një sërë dobish shëndetësore të agjërimit:[17]

Phoca PDF

1) Hulumtimet në teren e që target apo fokus grup patën një numër të madh të sëmurësh kanë vërtetuar se agjërimi shëron kancerin dhe se ndikon, në njërën anë në bllokimin e qelizave kancerogjene dhe në anën tjetër frenon shkaqet që shkaktojnë çrregullime në sistemin e punës së qelizave. Së këndejmi, mjekët porosisin për domosdoshmërinë e agjërimit si ilaç ruajtës, i cili pengon shndërrimin e qelizave të shëndosha në qeliza të infektuara me kancer.

2) Me avancimin dhe përparimin teknologjik dhe ndotjen që bartë me vete ky zhvillim, qoftë kjo ndotje me helme, apo ndotje energjike, ndotje zhurmuese për shkak të zhurmës dhe ndriçimit të tepërt gjatë natës, ekspertët kanë zbuluar një sekret të ri tek agjërimi disa ditor, i cili largon këto helme nga trupi pa efekte anësore. Kirurgët janë të paaftë për të larguar të gjitha helmet nga qelizat e trupit ngase trup përmban hiç më pak se disa miliardë qeliza, kështu që në këto raste agjërimi paraqitet për të pastruar këto qeliza pa ndonjë dëm. Kjo s'ka si të mos jetë sekret prej sekreteve të agjërimit.

3) Kush nuk vuan prej nesh nga brengat e shumta të kësaj kohe për shkak të problemeve materiale, psikike, shoqërore dhe të tjera si pasojë e shekullarizmit?! Ekonomia amerikane vetëm për problemet psikike paguan një kosto vjetore prej miliarda dollarësh edhe pse nuk sheh ndonjë rezultat konkret nga këto shpenzime. Ekspertët e fushave të ndryshme kanë vërtetuar se agjërimi ka ndikim marramendës në qetësimin dhe stabilizimin shpirtëror të njeriut si dhe në zgjidhjen e një mori të madhe problemesh shoqërore dhe familjare të tij.

4) Si sëmundje e kësaj kohe merret mbipesha e cila shkakton sëmundje tjera të rrezikshme si ato të zemrës, tensionit të gjakut, diabetit, kolesterolit, kurrizit, etj. realisht prej këtyre apo prej disa prej tyre vuan gjysma e shoqërisë. Me gjithë përparimin e mjeteve mjekuese, mjekët vazhdojnë me ngulm të vërtetojnë se agjërimi është shërimi i vetëm efektiv për të gjitha këto sëmundje.

5) Agjërimi është shërues nga shumë doke dhe zakone të këqija që shpërbëjnë shoqërinë, si konsumimi i duhanit, lëndëve narkotike, alkoolit, shikimit në gjëra të ndaluara. Nuk ka vend për tu çuditur për rëndësinë e agjërimit kur shohim se ata që preferojnë agjërimin si mënyrën më përfikte për shërim janë pikërisht mjekët jomyslimanë.

6) Një studim i ri ka vërtetuar se agjërimi zgjat jetën e qelizave dhe ngrit sistemin imunitar të njeriut, e si rezultat agjëruesit në krahasim me të tjerët jetojnë më gjatë. Këto janë disa sekrete të agjërimit që ftojnë besimtarin të shijojë ëmbëlsinë e këtij adhurimi sidomos tash në Ramazan. Ngritja e fuqisë efektive tek agjëruesit si pasojë e abstenimit nga ushqimi dhe pija, dhe shtimi i fuqisë së qelizave imunitare për të kryer punën e tyre dhe për të freskuar dhe aktivizuar sistemin imunitar nënkupton një gjë të rëndësishme, dhe e cila është: fuqia e trupit të agjëruesit për të shëruar të gjitha sëmundjet pa përjashtim.

II. ANALIZIMI I SHKAQEVE DHE ARSYETIMEVE TË ATYRE QË NUK AGJËROJNË DHE QË HANË E PINË NË PUBLIK GJATË DITËS NË RAMAZAN

II.1. MUNGESA E DITURISË FETARE PËRKITAZI ME AGJËRIMIN

Për agjërimin e Ramazanit, ndonëse është obligim fetar i detyrueshëm, dinë fare pak qytetarë të kësaj ane. Shumica e respondentëve janë përgjigjur se nuk e dinë normën përkatëse të

Phoca PDF


agjërimit në Islam. Prej të gjitha grupmoshave të respondentëve, 41% e dinë normën derisa 59% e tyre nuk e dinë atë ose mendojnë se është çështje vullnetare, pra jo obligim. Vlen të theksohet se nga respondentët, më së miri në këtë çështje kanë dalë gjeneratat e reja, pasi që shumica e tyre (83.3%) janë përgjigjur pozitivisht për normën e agjërimit. Tabela në vijim do ta pasqyron gjendjen në mënyrë më konkrete:


Target grupi	Përgjigjet pozitive	Përgjigjet negative
Mosha e re (15-25)	25/30 (83.3%)	5/30 (16.6%)
Mosha e mesme (25-55)	14/40 (35%)	26/40 (65%)
Mosha e vjetër (55-)	2/30 (6.6%)	28/30 (93.3%)
Gjithsej	41/100 (41%)	59%

Nga të anketuarit ose respondentët, pozitivisht në dijen për normën fetare kanë dalë më shumë meshkujt se sa femrat. Nga meshkujt, 30% dinë për normën e agjërimit ndërsa nga femrat vetëm 11%. Gjendja më e mirë qëndron tek grupmosha e re, të cilët dinë më shumë se grupmoshat tjera për normën e agjërimit. Tabela e mëposhtme sjell detajet:

Target grupi	Meshkujt	Femrat
Mosha e re (15-25)	20/30 (66.6%)	5/30 (16.6%)
Mosha e mesme (25-55)	9/40 (22.5%)	5/40 (12.5%)
Mosha e vjetër (55-)	1/30 (3.3%)	1/30 (3.3%)
Gjithsej	30/100 (30%)	11/100 (11%)

Ndërsa, përgjithësisht, përgjigjet pozitive sipas grupmoshave dhe gjinive të paraqitura në diagram duken kështu:





Respondentët kanë zbuluar se nuk kanë njohuri as sa i përket efekteve dhe dobive edukative dhe shëndetësore të agjërimit. Kjo mbase është dhe një shkak pse qytetarët nuk janë motivuar për të agjëruar. Në pyetjen nëse dinë për ndikimin e agjërimit në shëndetin shpirtëror, fizik dhe moral, përgjigjet në të gjitha rastet kanë qenë jo të mira. Edhe në këtë rast, grupmosha e re prinë pozitivisht, qoftë për numër më të madh të atyre që dinë për efektet pozitive të agjërimit në fushat përkatëse (43%), qoftë për numër më të vogël të atyre që nuk dinë fare (6.6%). Grupmosha e vjetër (55-) qëndrojnë më së keqi në këtë drejtim, pasi që 66% nuk dinë fare për efektet e agjërimit.

Phoca PDF

Tabela në vazhdim do ta pasqyrojë këtë gjendje në mënyrë më të detajuar. Në pyetjen drejtuar respondentëve për atë nëse agjërimi kishte ndikim në edukimin shpirtëror, moral dhe social të individit, kemi marrë këto përgjigje:

Target grupi	**Shumë**	**Mesatarisht**	**Pak**	**Fare**
Mosha e re (15-25)	13/30 (43%)	8 (26.6%)	7 (23.3)	2 (6.6%
Mosha e mesme (25-55)	12/40 (30%)	8 (20%)	11 (27.5%)	9 (22.5
Mosha e vjetër (55-)	2/30 (6.6%)	4 (13.3%)	2 (6.6%)	2 (6.6%
Gjithsej	27/100 (27%)	20/100 (20%)	20/100 (20%)	13/100 (13%)

Edhe në këtë aspekt, meshkujt prijnë sa i përket njohurive për vlerat dhe efektet e agjërimit. Në të gjitha grupmosha, meshkujt janë më përpara femrave. Nga të gjithë respondentët që janë përgjigjur pozitivisht, 19% del të jenë meshkuj ndërsa vetëm 8% janë femra. Tabela më poshtë sjell detajet nëpër grupmosha:


Target grupi	**Meshkujt**	**Femrat**
Mosha e re (15-25)	9/30 (30%)	4/30 (13.3%)
Mosha e mesme (25-55)	8/40 (20%)	4/40 (10%)
Mosha e vjetër (55-)	2/30 (6.6%)	
Gjithsej	19/100 (19%)	8/100 (8%)

Mungesa e njohurive për agjërimin, si normë, por edhe si vlerë dhe reflektim pozitiv në jetën e individit dhe shoqërisë, ka pasojat e veta. Kjo ka reflektuar edhe tek arsyetimet pse nuk agjërojnë. Në pyetjen për shkakun e drejtpërdrejtë se përse nuk agjërojnë, shumica absolute nuk kanë dhënë përgjigje të justifikueshme. Tabela e mëposhtme sjell detajet nga përgjigjet e tyre.

Target grupet	**Shëndeti i dobët**	**Puna e rëndë**	**Vapa dhe kohëzgjatja**	**Pamund. e brak.së duhanit**	**Thje nuk**
Mosha e re	1/30 (3.3%)	7 (23.3%)	7 (23.3%)		14 (4
Mosha e mesme	8/40 (20%)	11 (27.5%)	3 (7.5%)	4 (10%)	14 (3
Mosha e vjetër	5/30 (16.6%)	1 (3.3%)	1 (3.3%)		23 (7
Gjithsej:	14/100 (14%)	19/100 (19%)	11/100 11%)	4/100 (4%)	51/1

Nga analizimi i përgjigjeve, kemi vënë re se asnjë nga shkaqet e përmendura nuk janë arsyetime të mjaftueshme për të mos agjëruar, me përjashtim të një rasti nga grupmosha e re ku një femër është deklaruar se nuk agjëron për shkak se ishte shtatzënë. Tek mosha e vjetër ku shëndeti i ligë do të mund të ishte shkak serioz që pamundëson agjërimin vërejmë të kundërtën. Tek mosha e re dhe e mesme, puna e rëndë që mund të jetë shkak i braktisjes së agjërimit, nuk është evidentuar si shkak serioz. Tek shumica absolute nuk ka ndonjë arsye serioze për të mos agjëruar. Fatbardhësisht, duhani, me përjashtim tek mosha e mesme, nuk ka qenë shkak i theksuar. Pasqyrimi i shkaqeve të mos agjërimit në diagram.

Phoca PDF



Edhe në këtë drejtim, gjendja tek mosha e re qëndron më mirë se sa tek grupmosha tjera. Ndërsa, sa i përket gjinive, gjinia mashkullore është më keq se ajo femërore. Nga anketa del se:

	Shën. i dob.		**Pun. e rën.**		**Vapa**		**Duhani**			**Pa**
	M	F	M	F	M	F	M	F		M
Mosha e re	1		7		5	2				8
Mosha e mesme	5	3	10	1	2	1	4			11
Mosha e vjetër	2	3	1		1					11
Gjithsej	7/100 (7%)	6/100 (6%)	18/100 (18%)	1/100 (1%)	8/100 (8%)	3/100 (3%)	4/100 (4%)			30/ (30

II.2. MATËS TË ARSYETIMEVE TË MOSAGJËRIMIT

Se përgjigjet nuk janë të justifikueshme, tregojnë edhe matësit në vijim:

1-2) Konsultimi me mjekë dhe hoxhë

Ndonëse arsyetimet kanë të bëjnë me gjëra për të cilat do të duhej konsultuar mjekun, p.sh. për shëndeti e lig, për punën e rëndë, për vapën dhe rreziqet e saj për shëndetin, megjithatë, konsultimet kanë munguar, veçanërisht tek shtresa e vjetër. Tek mosha e re vihet një kujdes pak më i madh, ndonëse gjendja nuk është e mirë, derisa tek shtresa e mesme dhe ajo e vjetra,

Phoca PDF

e veçmas tek kjo e fundit, gjendja është shumë e keqe. Tabela në vazhdim tregon për gjendjen e konsultimit me mjek për çështjet e përmendura sipër.

Target grupet	**Janë konsultuar**	**Nuk janë konsultuar**
Mosha e re (15-25)	16/30 (53.3%)	14/30 (46.6%)
Mosha e mesme (25-55)	18/40 (45%)	22/40 (55%)
Mosha e vjetër (55-)	1/30 (3.3%)	29/30 (96.6%)
Gjithsej:	35/100 (35%)	65/100 (65%)

Po kështu, kanë munguar edhe konsultimet me hoxhallarë, kur dihet se për shumë nga këto çështje ka norma të veçanta fetare, p.sh. për ata që kanë shëndetin e ligë, megjithatë, respondentët nuk janë konsultuar me ta. Gjendja në këtë drejtim është edhe më e rëndë. Tabela e mëposhtme pasqyron gjendjen në mënyrë më të hollësishme:

Target grupet	**Janë konsultuar**	**Nuk janë konsultuar**
Mosha e re (15-25)	13/30 (43.3%)	17/30 (56.6%)
Mosha e mesme (25-55)	18/40 (45%)	22/40 (55%)
Mosha e vjetër (55-)	1/30 (3.3%)	29/30 (96.6%)
Gjithsej:	32/100 (32%)	68/100 (68%)

Ndërsa sipas gjinive, gjinia femërore del të jetë më mbrapa se gjinia mashkullore përkitazi me konsultimin me mjekë dhe hoxhallarë përkitazi me agjërimin. Tabela në vazhdim e pasqyron në detaje këtë gjendje:

	Konsultimi me mjek					**Konsultimi me hox**	
	Meshkujt		Femrat			Meshkujt	
Target grupet	Po	Jo	Po	Jo		Po	Jo
Mosha e re (15-25)	11	4	5	10		9	6
Mosha e mesme (25-55)	13	7	5	15		13	3
Mosha e vjetër (55-)		15	1	14			15
Gjithsej	24/100 (24%)	26/100 (26%)	11/100 (11%)	39/100 (39%)		22/100 (22%)	24/100 (24%)

3) Njohuritë rreth agjërimit

Shkak i kësaj gjendje padyshim se është edhe mungesa e njohurive përkitazi me agjërimin dhe vlerën e tij. Në pikën e parë të këtij kapitulli, diskutuam mungesën e njohurive nga këndvështrimi i normës dhe dispozitës fetare, në njërën anë, dhe dobive shëndetësore dhe shpirtërore, në anën tjetër. Diskutimi këtu është një plotësim i pikës së parë ndërsa në fokus do të ketë vetëm pyetjen nëse këta që nuk praktikojnë agjërimin, lexojnë literaturë fetare dhe shkencore për agjërimin apo jo. Nga anketa del gjendja nuk është aspak e mirë. Shumica e të respondentve nuk lexojnë për agjërimin. Tabela më poshtë sjell detajet:

Target grupi	**Lexojnë**	**Lexojnë pak**	**Nuk lexojnë fare**

Phoca PDF

Mosha e re (15-25)	6/30 (20%)	20/30 (66.6%)	4/30 (13.3%)
Mosha e mesme (25-55)	2/40 (5%)	18/40 (45%)	20/40 (50%)
Mosha e vjetër (55-)		3/30 (10%)	27/30 (90%)

Gjithsej:	8/100 (8%)	41/100 (41%)	51/100 (51%)

Siç mund të shihet, në të gjitha grupmoshat ka krizë sa i përket leximit fetar. Ndërsa sa i përket gjinive, gjendja është siç vijon:

Target grupet	**Meshkujt**			**Femrat**		
	Lex.	Lex. pak	Nuk lex.	Lex.	Lex. pak	N
Mosha e re (15-25)	4/30	10/30	1/30	5/30	7/30	3
Mosha e mesme (25-55)	2/40	17/40	1/40		1/40	1
Mosha e vjetër (55-)		1/30	14/30		2/30	1
Gjithsej	6/100 (6%)	28/200 (28%)	16/100 (16%)	5/100 (5%)	10/100 (10%)	3 (

Pra, siç mund të vërehet, gjendja e leximit tek gjinia mashkullore, në përgjithësi, qëndron më keq.

II.3. NDIKIMI I RRETHIT DHE AMBIENTIT

Në vendimin për të mos agjëruar dhe për të mospërfillur edukatën fetare për mos ngrënie në publik gjatë ditës në Ramazan, ndikim të veçantë kanë pasur tre element: familja, rrethi dhe globalizmi (kultura perëndimore).

1) Ndikimi i familjes

Familja ka luajtur një rol kyç sa i përket mosagjërimi. Grupmosha e re vërehet se ka ndikim më të madh nga familja, pasi që, në të shumtën e rasteve, janë të varur prej tyre dhe presioni që ushtrojnë prindërit ndaj tyre reflektohet tek fëmijët. Një gjë që është për t'u theksuar se tek gjinia mashkullore ndikimi i familjes ka qenë më i madh. Kjo ndoshta për shkak se shumë prej tyre janë në punë ose në shkolla dhe dhembshuria prindërore i bën t'i detyrojnë të mos agjërojnë. Pastaj, për çudi, tek shtresa e mesme ndikimi është shumë i madh, dhe kjo me gjasë, jo për shkak të varësisë, por ndoshta krijimit të një ambienti familjar ku nuk praktikohet agjërimi, dhe kjo ndikon padyshim që të mos agjërohet.

Tabelat në vijim e pasqyrojnë gjendjen në detaje:

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	**Shumë**	**Mesatarisht**	**Pak**
Mosha e re (15-25)	14/30	16/30	
Mosha e mesme (25-55)	17/40	7/40	16/40
Mosha e vjetër (55-)	2/30	4/30	24/30
Gjithsej:	33/100 (33%)	27/100 (27%)	40/100 (40%)

Phoca PDF

2. Gjendja sipas gjinive brenda grupmoshave

Target grupi	**Meshkujt**			**Femrat**		
	Shumë	Mesa.	Pak	Shumë	Mesa.	Pak
Mosha e re (15-25)	11	4		3	12	
Mosha e mesme (25-55)	11	5	4	6	2	12
Mosha e vjetër (55-)	1	1	13	1	3	11
Gjithsej:	23/100 (23%)	10/100 (10%)	17/100 (17%)	10/100 (10%)	17/100 (17%)	23/100 (23%)

2) Ndikimi i shoqërisë

Tek ata që nuk kanë agjëruar dhe që kanë ngrënë e pirë publikisht rol ka luajtur edhe shoqëria e tyre. Më të ndikuarit nga shoqëria janë grupmosha e mesme dhe grupmosha e re ndërsa më pak të ndikuar janë grupmosha e vjetër. Kjo, për shkak të lidhjeve që kanë grupmosha e reja dhe të mesme e të cilat kanë ndikimin e vet, derisa grupmosha e vjetër ndikohen më pak, për shkak të krijimit të një personaliteti më stabil dhe më të qëndrueshëm. Edhe në këtë aspekt, gjinia mashkullore është më e rrezikuar, për shkak të shoqërisë më të gjerë dhe punëve dhe obligimeve që lidhen me shoqërinë.

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	**Shumë**	**Mesatarisht**	**Pak**
Mosha e re (15-25)	14/30	7/30	9/30
Mosha e mesme (25-55)	17/40	16/40	7/40
Mosha e vjetër (55-)	6/30	2/30	22/30
Gjithsej:	37/100 (37%)	25/100 (250%)	38/100 (38%)

2. Gjendja sipas strukturës gjinore brenda grupmoshave

Target grupi	**Meshkujt**			**Femrat**		
	Shumë	Mesa.	Pak	Shumë	Mesa.	Pak
Mosha e re (15-25)	11	3	1	3	4	8
Mosha e mesme (25-55)	13	2	5	4	14	2
Mosha e vjetër (55-)	4	1	10	2	3	10
Gjithsej:	28/100 (28%)	6/100 (6%)	16/100 (16%)	9/100 (9%)	21/100 (21%)	20/100 (20%)

3) Ndikimi i kulturës globale

Agjërimi i Ramazanit ka qenë një ndër praktikat fetare më të përhapura ndër qytetarë. Edhe ata që nuk e kanë praktikuar, publikisht nuk kanë ngrënë dhe as nuk kanë pirë. Ky ndryshimi që ka ndodhur viteve të fundit shkak ka edhe kulturën perëndimore, veçmas pas luftës e këndej. Ndikimi i kësaj kulture vërehet tek grupmosha, e reja dhe mesme, më shumë, ndërsa tek ajo e vjetra shumë më pak. Në nivel gjinish, përgjithësisht, gjinia femërore është më e prekur (duke e

llogaritur këtu bashkë ndikimin e shumtë dhe atë mesatar). Kjo ndoshta edhe për shkak se kjo kulturë ka prekur gjininë femërore më shumë. Tabelat e mëposhtme japin detaje.

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	**Shumë**	**Mesatarisht**	**Pak**
Mosha e re (15-25)	11/30	13/30	6/30
Mosha e mesme (25-55)	8/40	23/40	9/40
Mosha e vjetër (55-)	3/30	3/30	24/30
Gjithsej:	22/100 (22%)	39/100 (39%)	39/100 (39%)

2. Gjendja sipas strukturës gjinore brenda grupmoshave

Target grupi	**Meshkujt**			**Femrat**		
	Shumë	Mesa.	Pak	Shumë	Mesa.	Pak
Mosha e re (15-25)	7	3	5	4	10	1
Mosha e mesme (25-55)	7	7	6	1	16	3
Mosha e vjetër (55-)	1	1	13	2	2	11
Gjithsej:	15/100 (15%)	11/100 (11%)	24/100 (24%)	7/100 (7%)	28/100 (28%)	15/100 (15%)

II.4. QASJA NDAJ DUKURISË DHE VLERËSIMI PËR RITIN FETAR

Qasja e besimtarëve ndaj dukurisë së mosagjërimit ka mangësitë dhe përparësitë e veta. Nga një aspekt, është shumë e dëmshme dhe kërkon qasje shumë serioze, ndërsa aspekti tjetër është shpresëdhënës. Dera për të punuar me këta njerëz, për të ndryshuar qëndrimet e tyre të gabuara nuk është e mbyllur. Të fillojmë nga e para.

1) Çfarë mendimi kanë të respondentët për veprimet e tyre

Në pyetjen drejtuar respondentëve nëse e llogaritnin apo jo mëkat braktisjen e agjërimit, përgjigjet janë tejet shqetësuese. Shumica e tyre nga të gjitha grupmoshat nuk e llogarisin këtë veprim mëkat megjithëse braktisja e agjërimit është ndër mëkatet më të mëdha, pikërisht sepse agjërimi është shtylla e tretë e Islamit. Më konkretisht, janë vetëm 20% nga të gjithë respondentët që e konsiderojnë këtë veprim mëkat. Ja si duket përgjithësisht gjendja e atyre që e konsiderojnë braktisjen e agjërimit mëkat dhe të të tjerëve që nuk e konsiderojnë.

Phoca PDF



Pra, janë shumica absolute nga të gjitha grupmosha që konsiderojnë se ky veprim i tyre nuk është mëkat. Kjo është për shqetësim. Agjërimi është shtyllë e fesë dhe të kihet qëndrim të këtillë karshi kësaj shtylle është e papranueshme. Ky botëkuptim për agjërimin tek gjinia femërore është më shumë i thekuar. Për më shumë detaje shih tabelat në vijim:

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	**Po**	**Jo**
Mosha e re (15-25)	11/30	19/30
Mosha e mesme (25-55)	5/40	35/40
Mosha e vjetër (55-)	4/30	26/30
Gjithsej:	20/100 (20%)	80/100 (80%)

2. Gjendja sipas gjinive brenda grupmoshave

Target grupi	Meshkujt		Femrat	
	Po	Jo	Po	Jo
Mosha e re (15-25)	7	8	4	11
Mosha e mesme (25-55)	5	15	5	15
Mosha e vjetër (55-)	1	14	3	12
Gjithsej:	13/100 (13%)	37/100 (37%)	12/100 (12%)	38/10

Se kjo gjendje është për shqetësim flet edhe fakti tjetër se shumica absolute e këtyre nuk e kanë ndërmend të kompensojnë agjërimin. Pra, duke qenë se nuk e llogaritin mëkat, as që mendojnë të pendohen dhe të kompensojnë ditët e lëshuara. Nga anketa del se 80% e tyre nuk mendojnë ta kompensojnë agjërimin derisa vetëm 20% e tyre e shohin këtë mundësi. Janë kryesisht ata që kanë braktisur agjërimin për ndonjë arsye të caktuar dhe jo se e kanë refuzuar apriori.

Në pyetjen drejtuar respondentëve nëse do të kompensojnë apo jo ditët e lëshuara të

Phoca PDF

Ramazanit, shumica absolute janë përgjigjur negativisht. Tabela në vijim sjell detajet përkatëse.

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	Po	Jo
Mosha e re (15-25)	4/30	26/30
Mosha e mesme (25-55)	6/40	34/40
Mosha e vjetër (55-)	10/30	20/30
Gjithsej:	20/100 (20%)	80/100 (80%)

2. Gjendja sipas strukturës gjinore brenda grupmoshave

Target grupi	Meshkujt		Femrat	
	Po	Jo	Po	Jo
Mosha e re (15-25)	1	14	3	12
Mosha e mesme (25-55)	3	17	3	17
Mosha e vjetër (55-)	5	10	5	10
Gjithsej:	9/100 (9%)	41/100 (41%)	11/100 (11%)	39/100 (39%

Një gjë tjetër shqetësuese është këta që nuk përfillin agjërimin, nuk përfillin as adhurimet tjera fetare, dhe me këtë dëshmohet se arsyetimet si: vapa, kohëzgjatja, puna e rëndë, nuk janë të justifikueshme, pasi që në praktikimin e namazit, adhurim tjetër si shembull, këto nuk do të ndikon fare. Dhe kjo gjendje është evidente tek të gjitha grupet. 61% është totali i përgjithshëm i atyre që nuk falen dhe nuk kryejnë adhurimet tjera derisa numri i praktikuesve të riteve fetare është 39%, prej të cilëve 11% i kryejnë të gjitha ritet ndërsa 28% i kryejnë pjesërisht. Më poshtë tabelat japin detajet e kësaj gjendje.

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	Po	Pjesërisht	Jo
Mosha e re (15-25)	8/30	9/30	13/30
Mosha e mesme (25-55)	3/40	16/40	21/40
Mosha e vjetër (55-)		3/30	27/30
Gjithsej:	11/110 (11%)	28/100 (28%)	61/100 (61%)

2. Gjendja sipas strukturës gjinore brenda grupmoshave

Target grupi	Meshkujt			Femrat		
	Po	Pjes.	Jo	Po	Pjes.	
Mosha e re (15-25)	5	2	8	3	7	
Mosha e mesme (25-55)	3	13	4	3	12	
Mosha e vjetër (55-)		1	14		2	
Gjithsej:	8/100	16/100	26/100	6/100	21/100	

Phoca PDF

	(8%)	(16%)	(26%)	(6%)	(21%)	

Ndërsa gjërat që shihen si mirësi në këtë fatkeqësi janë qasja e tyre ndaj dukurisë së të ngrënit dhe pirit në publik. Megjithëse shumica (52%) mendojnë se kjo çështje është personale, 48% mendojnë se është gabim, që nënkupton se hapësira për të punuar dhe për të ndryshuar bindjet e gabuara për agjërimin e Ramazanit ekziston, veçmas me moshën rinore, shumica e të cilëve mendojnë se është gabim ajo çfarë bëjnë. Por, gjendja më e keq del të jetë tek mosha e mesme, pasi që 47.5% tyre mendojnë se nuk gabojnë, ndërsa edhe shumë më keq tek mosha e vjetër, pasi që ngaqë shumica absolute (83%) nuk mendojnë se gabojnë kur hanë apo pinë në publik.

Në pyetjen se si e vlerësojnë shprehinë e të ngrënit në publik gjatë Ramazanit, kemi marrë këto përgjigje:

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	Gabim	E drejtë personale
Mosha e re (15-25)	22/30 (73.3%)	8/30
Mosha e mesme (25-55)	21/40	19/40 (47.5%)
Mosha e vjetër (55-)	5/30	25/30 (83.3)
Gjithsej:	48/100 (48%)	52/100 (52%)

2. Gjendja sipas strukturës gjinore brenda grupmoshave

Target grupi	Meshkujt		Femrat	
	Gabim	E drj. per.	Gabim	E drj. p
Mosha e re (15-25)	14	1	8	7
Mosha e mesme (25-55)	15	5	6	14
Mosha e vjetër (55-)	3	12	2	13
Gjithsej:	32/100 (32%)	18/100 (18%)	16/100 (16%)	34/100

Ndërsa sa i përket qëndrimit të tyre karshi atyre që praktikojnë agjërimin, qëndrimi i tyre përgjithësisht është i mirë, pasi që 40% prej tyre mendojnë se është vepër e qëlluar derisa 32% e konsiderojnë si të drejtë personale ndërsa 28% si punë të kotë. Në të gjitha rastet, statistikat thërrasin për të punuar me këta njerëz, për shkak se, nëse e kemi derën e hapur tek 40%, atëherë edhe pjesës tjetër, e veçmas tek këta që nuk kanë konsideratë për agjërimin, duhet t'i kushtojmë vëmendje. Prapë gjendja për të mirë dallon tek mosha e re (56.6%), dominon tek mosha e mesme (42.5%) ndërsa është e përmbytur tek mosha e vjetër (70%). Tabela në vijim sjell detajet.

1. Evidentimi i gjendjes sipas grupmoshave

Target grupi	E drejtë per.	Vep. e qëlluar	Kot fare
Mosha e re (15-25)	13/30 (43.3%)	17/30 (56.6%)	
Mosha e mesme (25-55)	16/40 (40%)	17/40 (42.5)	7/40 (17.5%)
Mosha e vjetër (55-)	3/30 (10%)	6/30 (20%)	21/30 (70%)

Phoca PDF

Gjithsej:	32/100 (32%)	40/100 (40%)	28/100 (28%)

2. Gjendja sipas gjinive brenda grupmoshave

Target grupi	Meshkujt			Femrat	
	E dre. per.	Vep. e qëll.	Kot fare	E dre. per.	Vep. e
Mosha e re (15-25)	6	9		7	8
Mosha e mesme (25-55)	10	7	3	6	10
Mosha e vjetër (55-)	2	2	11	1	4
Gjithsej:	18/100 (18%)	18/100 (18%)	14/100 (14%)	14/100 (14%)	22/100 (22%)

PËRFUNDIM

Përse nuk agjëruan disa qytetarë vushtrrias dhe çfarë i bëri të hanë e pinë në publik?

Të gjeturat e hulumtimit udhëzojnë për një mori shkaqesh që kanë ndikuar në vendimin për të mos agjëruar e më pas edhe për ta manifestuar atë në publik. Ato, si më kryesoret, janë siç vijon:

1) Mungesa e njohurive themelore për fenë, në përgjithësi, dhe agjërimin, në veçanti. Shumica e të anketuarve rezultojnë me njohuri të pamjaftueshme për dispozitat fetare përkitazi me agjërimin.
2) Mungesa e njohurive për efektet shpirtërore, shoqërore dhe fizike të agjërimit. Njohja me efektet pozitive të agjërimit në jetën e individit dhe shoqërisë është një motiv i madh për të agjëruar. Siç kemi përmendur në pjesën e parë, agjërimi ka një ndikim pozitiv shumëdimensional tek besimtari. Megjithëkëtë, shumë pak nga respondentët tanë kanë ditur për këtë karakteristikë të agjërimit, edhe pse literatura fetare dhe shkencore për agjërimin është në nivel të kënaqshëm.
3) Qasja jo serioze ndaj fesë dhe obligimeve fetare, pasi që arsyet e ofruara për mos agjërim, janë të pajustifikueshme, veçanërisht pas vërtetimit të studimit se shumica e të anketuarve nuk kanë konsultuar mjekun dhe hoxhën për vendimet e tyre për të mos agjëruar. Shumica prej tyre thjesht nuk kanë agjëruar.
4) Ndikimi negativ i familjes, rrethit dhe kulturës. Është parë se shumë nga ata që nuk kanë agjëruar janë të ndikuar nga familja, shoqëria, e mbase edhe nga kultura në trend, e cila nuk i ka lënë fesë hapësirë. Ndikimi i familjes është vënë re më shumë tek gjeneratat e reja, të cilat janë të varura ekonomikisht prej tyre. Në vend se familja të luante rol pozitiv, siç ka qenë tek gjenerata e para të muslimanëve, ku agjërimi në familje është promovuar si një mënyrë trajnimi e fëmijëve për tu ballafaquar me sfida, fatkeqësisht është e kundërta sot. Familja është pengesë. Ndikim negativ kanë patur edhe shoqëria dhe trendi i ri i saj kulturor, që fenë disi e ka përjashtuar nga skena shoqërore. Kultura ka patur ndikim edhe tek diaspora jonë.
5) Perceptimi i gabuar i të drejtës. Një nga shkaqet pse nuk agjërohet dhe, për pasojë, hahet dhe pihet në publik, është qasja shumë e gabuar ndaj fesë. Është një imazh i llojit të vet i jo seriozitetit në raport me fenë, pasi që veprimet merren si të drejta personale. Nga perspektiva fetare, kjo qasje është e rrezikshme pasi që të shihet mos agjërimi, që është një nga mëkatet e mëdha dhe që bëhet edhe më i madh kur manifestohet publikisht, normal, kjo është e

Phoca PDF

papranueshme. Fakti se shumica e tyre nuk konsiderojnë se bëjnë mëkat dhe se nuk e kanë ndërmend të kompensojnë agjërimin e lëshuar, e fuqizon edhe më shumë këtë që po themi.

Duke patur parasysh këto shkaqe dhe këtë gjendje, si rekomandime të hulumtimit do të veçoja:

1) Organizimi i kampanjave vetëdijësuese përkitazi me agjërimin, për shkak se qytetarët që nuk agjërojnë, nuk dinë për agjërimin, vlerat dhe rëndësinë e tij. Kampanja duhet të përfshije elementet e përmendura sipër (normat dhe rëndësinë), sikur që duhet të ofrojë shpjegime të mjaftueshme për gjëra që kanë të bëjnë me probleme bashkëkohore për agjërimin. Do të kishte qenë mirë që kampanja të jetë e shtrirë në të gjitha fushat: TV, radio, mediat elektronike, mediat e shtypura, rrjetet sociale, librat, etj. Kjo është edhe arsyeja pse ky punim publikohet në këtë kohë (disa muaj para Ramazanit), në mënyrë që të merret seriozisht kjo kampanjë.
2) Hoxhallarët dhe thirrësit duhet të jenë në kontakt më të shpeshtë me popullin, pasi që vërehet mungesa e këtij kontakti në vendimet e gabuara të xhematit – popullit. Nuk është vetëm agjërimi që nuk praktikohet nga qytetarët e anketuar, janë dhe adhurimet tjera, andaj duhet qenë në nivelin më të lartë të punës dhe përgjegjësisë.
3) Të punohet me të gjitha gjeneratat, e veçmas me të rinjtë, disponimi i të cilëve për fenë është një mirësi në këtë fatkeqësi.
4) Të punohet me gjininë femërore më shumë, qoftë kjo nëpërmjet mbajtjes së organizimeve fetare enkas për femra, qoftë në forma të tjera, pasi që nevoja është e madhe ndërsa disponimi i tyre nuk mungon.
5) Të fuqizohet roli pozitiv i familjes. Kjo nënkupton se duhet punuar shumë me prindërit që të jenë mbështetës për fëmijët e tyre e jo pengesë. Pjesë e kampanjës duhet të jetë edhe familja dhe roli i saj në edukimin e mirëfilltë të gjeneratave të reja.
6) Të luftohen dukuritë negative në shoqëri, veçanërisht dukuria e të ambientuarit me mëkatin. Anketa na ka mësuar se shumica e atyre që nuk agjërojnë konsiderojnë se nuk kanë bërë mëkat dhe se edhe qëndrimi i tyre karshi atyre që agjërojnë është me këtë logjikë: e drejtë e tyre. Detyrimet janë detyrime dhe neglizhimi i tyre ka pasoja fetare dhe shoqërore.
7) Të organizohen ditë të diasporës, në të cilat do të mbaheshin kurse fetare. për shkak se këto vitet e fundit Ramazani po bie në kohën kur janë edhe pushimet verore, vërehet se një ndikim e kanë edhe një pjesë e diasporës sonë, që nuk janë të kujdesshëm sa duhet karshi obligimeve fetare.
8) Të bëhet një studim në nivel të Republikës, në mënyrë që të organizohet kampanjë e përbashkët në nivel të BIRK-së. Sigurisht, shumë nga shkaqet mund të jenë të ngjashme, por mund të ketë edhe të tjera të veçanta, andaj studimet lokale mund të ofrojnë hollësi dhe detaje shumë me rëndësi.

Për fund, jam i vetëdijshëm se gjatë anketës dhe analizimit të saj mund të jenë përvjedhtë gabime dhe lëshime me gjithë interesimin tonë për saktësi më të madhe, por më mjafton që jam munduar të bëj më të mirën. Allahun e lus të më shpërblejë për suksesin ndërsa të më falë për gabimet dhe lëshimet.

SHTOJCË

PYETËSORI

I nderuar bashkëqytetar,

Phoca PDF

Ju jeni përzgjedhur për të qenë pjesë e një studimi përkitazi me mosagjërimin e muajit Ramazan. Studimi mëton vetëm evidentimin e shkaqeve dhe arsyeve, si material për studime tjera, fetare dhe sociologjike. Të dhënat tuaja do të mbesin të ruajtura.

Ju lutem, mbushni rubrikat e mëposhtme:

Emri:..... Mbiemri: .....

Mosha:

? 15-25
? 25-55
? 55-

Gjinia:

? M
? F

Profesioni:

? Nxënës
? Student
? Punëtor
? Pensionist
? Ju lutem specifikojeni:
.....

Rezident:

? Kosovë
? Diasporë

Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve në vijim duke rrumbullakësuar njërën nga përgjigjet e dhëna!

1. Cila është norma e agjërimit në Islam:

? Obligim për secilin moshërritur
? Çështje vullnetare
? Nuk e di

2. Sa ndikon agjërimi në edukimin shpirtëror, moral, social dhe shëndetësor të individit?

? Shumë
? Mesatarisht
? Pak
? Fare

Phoca PDF

? Nuk e di

3. Cili është shkaku që nuk agjëroni?

? Shëndeti i dobët
? Puna e rëndë
? Vapa dhe kohëzgjatja
? Pamundësia e braktisjes së duhanit
? Thjesht, nuk agjëroj
? Tjetër, ju lutem specifikojeni:
.....

4. Në rast se nuk agjëroni për shkak të shëndetit, jeni konsultuar me ndonjë mjek kompetent për këtë gjë?

? Po
? Jo

5. Në rast se nuk agjëroni për shkak të punëve të rënda dhe vapës, jeni konsultuar për këtë vendim me ndonjë hoxhë?

? Po
? Jo

6. Nëse keni braktisur agjërimin për arsye shëndeti dhe pune, a do të kompensoni ditët e lëshuara kur të shëroheni, respektivisht gjeni kohën e lirë?

? Po
? Jo

7. Në rast se nuk keni asnjë arsyetim për të mos agjëruar, atëherë konsideroni se keni bërë mëkat apo jo?

? Po
? Jo

8. Keni lexuar ndonjë libër që flet për agjërimin nga këndvështrimi fetar dhe shkencor?

? Po
? Pak
? Jo

9. Nëse nuk agjëroni, atëherë a kryeni obligimet tjera fetare?

? Po
? Pjesërisht
? Jo

Phoca PDF

10. Sa ndikon ambienti familjar në mospraktikimin e agjërimit?

? Shumë
? Mesatarisht
? Pak

11. Sa ndikojnë rrethi dhe shoqëria në mospraktikimin e agjërimit?

? Shumë
? Mesatarisht
? Pak

12. Sa ndikon kultura perëndimore në mospraktikimin e agjërimit?

? Shumë
? Mesatarisht
? Pak

13. Si e konsideroni shprehinë e të ngrënit dhe pirjes në publik gjatë Ramazanit?

? Gabim
? E drejtë personale

14. Si e vlerësoni vendimin e të tjerëve për të agjëruar?

? E drejtë e tyre
? Vepër e qëlluar
? Kot fare

Ju faleminderit për kohën e ndarë për t'iu përgjigjur këtij pyetësori!

---

1 Hadithi transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi. Teksti është i Muslimit.
2 Termi "shka" është përdorur si koncept, jo si emër, nga besimtarët për të dalluar myslimanin nga jomyslimani. Kështu, në këtë mënyrë, e kanë përdorur edhe jomyslimanët termin "turk" për të dalluar muslimanët prej tyre.
3 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
4 Taberiu, Muhammed ibn Xherir. (2001) Xhamiu-l-bejan an te'vili aji-l-Kur'an. Kajro: Dar Hixhr li-t-tibaati ve-n-neshri ve-t-teuzië ve-l-i'lan. 3/153.
5 Ibni Kethir, Ebu-l-Fida Ismail ibn Umer. (1999) Tefsiru-l-Kur'ani-l-Adhim. Kajro: Dar Tajjibe li-n-neshr ve-t-teuzië. 1/503.
6 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
7 Ibni Hazm, Ebu Muhammed Ali ibn Ahmed ibn Seid. (p.v.b.) Meratibu-l-ixhmaë fi-l-ibadat ve-l-muamelat ve-l-i'tikadat. Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijjeh. F. 39.

Phoca PDF

8 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
9 Transmeton Buhariu.
10 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
11 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
12 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
13 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
14 Transmeton Buhariu.
15 Transmeton Tirmidhiu.
16 Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.
17 Shih: Seb'atu erar xhedideh li-s-savm, http://www.kaheel7.com/ar/index.php/2010-02-02-22-25-21/364-2011-07-30-14-09-20

Phoca PDF